MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN GJEPALAJ, DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Gjepalaj, Durrës, Tiranë, me objekt: "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, programimit dhe realizimit së të ardhurave vendore, funksionimin e policisë së komunës dhe funksionimi dhe organizimi i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik"dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.41 , datë 28.03.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 434/6, datë 28.03.2012, dërguar **z. Ardian Kokomani,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të mos jepen leje ndërtimi, pa përfunduar më parë plani territorial vendor nga autoritetet përkatëse të planifikimit, si dhe sigurohet që ai të përmbush standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

Menjëherë

2. Të merren masa nga Komuna Gjepalaj për fillimin e procedurave për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin e plotë, azhurnimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve, pronë e komunës dhe të aplikohet në ZVRPP Durrës, për regjistrimin sipas listës emërore të pronësisë.

Menjëherë

3. Të merren masa për ngritjen e një grupi të përbashkët pune me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Durrës, për të verifikuar dhe azhurnuar gjendjen faktike të sipërfaqes prej 52.45 ha fond pyjor e kullosor, kaluar në pronësi të Komunës Gjepalaj sipas VKM nr. 173, datë 13.02.2008 dhe procesverbalit të dorëzimit nr. 349, datë 27.7.2011, mbajtur ndërmjet DSHP Durrës dhe Komunës Gjepalaj. Pas verifikimit dhe azhurnimit të gjendjes faktike, të zbatohen procedurat ligjore për regjistrim ose ndryshim të zërit kadastral.

Brenda datës 31.12.2012

4. Të merren masa për ngritjen si strukturë e veçantë të njësisë së prokurimit, duke rekrutuar specialistë të kualifikuar në këtë fushë, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Menjëherë

5. Të merren masa për ngritjen e komisionit për faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor, në zbatim të ligjit nr. 10418 datë 21.4.2011 "Për legalizimin dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor".

Menjëherë

6. Të merren masa për riorganizimin e zyrës së urbanistikës, për një zhvillim të efektshëm, të frytshëm dhe të drejtë të territorit nën juridiksionin komunës, sipas kritereve dhe rregullimeve të bëra me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar**.**

Menjëherë

7. Të riorganizohet zyra e financës me qëllim që të implementohen kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontabilitetin", UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlera të vogla dhe të larta", si dhe kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile".

Brenda datës 31.3.2012

8. Të riorganizohet komisioni i blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla me qëllim që të eliminohen shkeljet e konstatuara, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Menjëherë

9. Të zbatohen procedurat ligjore për marrjen, administrimin, vlerësimin dhe përdorimin e automjeteve në inventar të Komunës, të cilat disponohen nga ish-punonjës të kësaj komune, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Konkretisht për automjetin tip motoçikletë me vlerë 71,000 lekë, automjetin veturë tip FIAT me vlerë 34,700 lekë dhe autoveturën veturë tip VW Golf me vlerë 280,000 lekë.

Brenda datës 31.3.2012

10. Në çdo rast, punimet për rikonstruksionin e rrugëve të kryera me mjetet e veta, të bëhen mbi bazën e projekteve, preventivave, situacioneve përkatëse, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të tij.

Në vazhdimësi

11. Konsumi i karburantit për automjetet e komunës, të kryhet në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Në vazhdimësi

12. Dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacionin e përcaktuar në Aneksin I dhe II të VKM nr. 355, datë 07.7.2000 "Për organizimin e dosjes dhe regjistrit të personelit".

Brenda datës 31.03.2012

13. Për taksat vendore të ndërmerret iniciativa për hartimin e skemës kontabile, e cila të plotësojë parimin e të drejtave të konstatuara, duke bashkëpunuar në këtë iniciativë me Ministrinë e Financave.

Brenda datës 31.12.2012

14. Të rakordohet me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, ZVRPP Durrës, për evidentimin, administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore disponibël në juridiksionin e komunës.

Brenda datës 31.12.2012

15. Punonjësit e policisë komunare të pranohen në detyrë vetëm pasi të kenë marrë formimin në Akademinë e Rendit Publik apo Akademinë e Policisë së Rendit dhe emërimi në detyrë të bëhet me komision të posaçëm, të cili kryesohet nga Përgjegjësi i Policisë së Komunës dhe në përbërje të jenë edhe të deleguar nga Prefektura e Qarkut, si dhe përfaqësues nga Komisariati i Policisë, Durrës.

Brenda datës 30.6.2012

16. Policia Komunare dhe zyra e taksave vendore, të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për rakordimin dhe marrjen e masave ndaj të gjitha subjekteve të pa regjistruar dhe ndaj atyre që nuk kanë derdhur detyrimet vendore.

Në vazhdimësi

17. Policia Komunare dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Komunës, të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për çdo rast në evidentimin dhe ndalimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit administrativ të komunës dhe sipas rastit deri në prishjen e objekteve ndërtimore të ngritura pa leje ndërtimi, apo në kundërshtim me atë të miratuar.

Në vazhdimësi

18. Policia Komunale dhe zyra e taksave duhet të mbajnë korrespodencë të protokolluar ndërmjet tyre, si për subjektet e palicencuara ashtu dhe ndaj atyre që nuk kanë derdhur detyrimet vendore.

Në vazhdimësi

19. Punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës, të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

Brenda datës 31.12.2012

20. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Komunës, të hartojë planet vjetorë, për ushtrimin e kontrolleve sipas drejtimeve të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

Në vazhdimësi

21. Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës në të gjitha rastet, kur konstaton objekte pa leje ndërtimi dhe shtesa kati pa leje mbi objektet ekzistuese, për të cilat është mbajtur procesverbal, duhet të vazhdojë proceduarat ligjore për pezullimin e punimeve, vendosje gjobe, deri në marrjen e vendimit për prishje objekti.

Në vazhdimësi

22. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Komunës, të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në të gjithë territorin nën administrim dhe të mos lejojë fillimin e punimeve nga ana e subjekteve, pa u pajisur më parë me leje ndërtimi.

Në vazhdimësi

23. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Komunës, të marrë masat për të gjitha rastet kur subjektet ndërtuese nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e ndërtimit:
Të vendosë gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
Të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesë për heqje licence profesionale, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit.
Të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.
Të përgatisë kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ti paraqesë ato pranë organeve përgjegjëse.

Në vazhdimësi

24. Kryeinspektori i INU të Komunës, të bashkëpunojë rregullisht me Seksionin e Financës, duke kërkuar dhe rakorduar arkëtimin e gjobave të vendosura nga INU, për të gjithë subjektet ndërtuese. Në të gjitha rastet kur konstatohet mos shlyerja e detyrimeve, Kryeinspektori të pezullojë punimet e ndërtimit, deri në shlyerjen e plotë të gjobave.

Në vazhdimësi

25. Në rast se Komuna Gjepalaj, nuk ka kapacitet njerëzore, ekonomike dhe logjistike për krijimin e strukturës së INU-t, sipas kërkesave të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, të delegojë në Qark, të drejtën e administrimit të planifikimit urban, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e sipërcituar. Delegimi të bëhet nëpërmjet nënshkrimit të akt-marrëveshjes midis Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në Qark dhe Komunës Gjepalaj.

Brenda datës 31.12.2012

26. Kryetari i Komunës Gjepalaj, të ngrejë një grup pune për hartimin e paketës ligjore mbi masat administrative që duhet të vendos policia komunare, për shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative.
Bazuar në relacionin e hartuar nga grupi i punës, Kryetari i Komunës ti paraqes Këshillit të Komunës Gjepalaj, miratimin e tarifave sipas llojit të shkeljeve. Detyrim ky i përcaktuar në nenin 6 "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative", shkronja a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Brenda datës 31.12.2012

<u>B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kërkohet në rrugë ligjore shuma prej 1.885.380 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e komunës, nga ku:
a. Shuma **198,480 lekë**, përfaqëson shpenzim për blerjen e luleve natyrale dekorative në vitin 2010 pa dokumentacion justifikues, të kryer me procedurën e blerjeve me vlera të vogla, në ngarkim të [redacted] me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, në kundërshtim

me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
b. Shuma **1,686,900 lekë**, përfaqëson përfitim të padrejtë në prokurimet me fondet publike, në 3 raste, përkatësisht nga shoqëria [redacted] Tiranë në vlerën 498,600 lekë, për objektin: "Asfaltim i rrugës "Gjepalaj- Shahinaj", viti 2009, shoqëria [redacted] Durrës në vlerën 793,500 lekë për objektin: "Ndërtim i shkollës Hardhisht", viti 2009, dhe shoqëria [redacted] sh.p.k në vlerën 394,800 lekë në objektin "Asfaltim i rrugës Gjepalaj Shahinaj", faza e dytë, viti 2011.
Veprime në kundërshtim me nenet 7, 8, 9, 11, 12, 14, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe paragrafi I, pika 1, 3, 4, paragrafi II, pika 3, 7, dhe "Kushtet teknike të zbatimit", paragrafi I, 5, 3 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
Brenda datës 31.12.2012

B. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Mbështetur në nenet 37, 141, 153 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, si dhe në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, kërkojmë nga Kryetari i Komunës Gjepalj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Zgjidhje e kontratës së punës", për:
1. [redacted] me detyrë përgjegjës i administratës për periudhën 04.10.2011 dhe në vazhdim, në cilësinë e ish-përgjegjësit të sektorit të urbanistikës për periudhën viti 2009-03.10.2011, si dhe në cilësinë e ish-inspektorit të tatimit mbi tokën bujqësore, pasi:
a. Në 1 rast është dhënë leje ndërtimi, si dhe shtatë vendime për destinacion shesh ndërtimi, pa vendim të KRRT-së së Komunës, firmosur pa kompetencë ligjore nga z. [redacted] me detyrë ish-kryetar komune në cilësinë e kryetarit të KRRT-së së Komunës, dhe [redacted] me detyrë përgjegjës i sektorit të urbanistikës, veprim në kundërshtim me nenin 20, pika 2/e, 21, dhe nenin 22/1, pika 7 dhe 9, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar.
b. Në një rast është dhënë leje ndërtimi, si dhe shtatë vendime për destinacion shesh ndërtimi, jashtë zonave të urbanizuara, jashtë planit të përgjithshëm rregullues të komunës dhe jashtë vijës kufizuese të ndërtimit, pa studim urbanistik pjesor, në tokë bujqësore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 6 dhe nenin 20, pika 1/dh, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar.
c. *Për ardhurat vendore.*
- mos bashkëpunim, mos bashkëveprim dhe mos rakordim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, për sa i përket sipërfaqes të ndërtesave, sipërfaqes të tokës bujqësore, si dhe të taksës të kalimit të pronësisë etj.
- Ka mos bashkëpunim, mos bashkëveprim dhe mos rakordim me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, ZVRPP Durrës, për evidentimin,

administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore disponibël në juridiksionin e Komunës Gjepalaj.

***"Vërejtje me paralajmërim"**, për:*

[redacted], me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, për:

- mos mbajtjen saktë të kontabilitetit financiar sipas kërkesat të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile".
- mos kontabilizim të detyrimeve vendore, mbajtjen e tyre ekstra kontabël, si dhe për mos ndërmarrje të asnjë iniciative për hartimin e skemës kontabile, që të plotësojë parimin e të drejtave të konstatuara, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj".
- kontroll jo të plotë dhe mos rakordim sistematik me zyrën e tatim taksave dhe të urbanistikës në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

[redacted] me detyrë inspektor i tatim taksave vendore, për:
- mos bashkëpunim, mos bashkëveprim dhe mos rakordim sa e si duhet me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Durrës.
- mos programim të saktë dhe mos arkëtim të plotë të taksës mbi ndërtesat dhe taksës mbi tokën bujqësore.
- mos bashkëpunim, mos bashkëveprim dhe mos rakordim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, për sa i përket sipërfaqes të ndërtesave, sipërfaqes të tokës bujqësore, si dhe të taksës të kalimit të pronësisë etj.
- mos bashkëpunim, mos bashkëveprim dhe mos rakordim me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, ZVRPP Durrës, për evidentimin, administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore disponibël në juridiksionin e Komunës Gjepalaj.
- mos programim të saktë të taksës së ndikimin të infrastrukturës nga ndërtimet e reja. Mos rakordim me specialistët e urbanistikës për marrjen e të dhënave të nevojshme, njëkohësisht mos realizim të treguesve të programuar.
- mos programim dhe mos arkëtim të taksës për zënien e hapësirave publike dhe taksës së fjetjes në hotel, edhe pse përcaktohet si detyrim në vendimet e këshillit të komunës sipas viteve respektive.
- mos bashkëpunim, bashkëveprim dhe rakordim me Drejtorinë Rajonale të Shfrytëzimit të Automjeteve Durrës, për programimin e taksës për regjistrim e automjeteve, si dhe për tarifën e transportit.

[redacted] punonjëse sociale, për:
-Mos zbatim të rregullave të prokurimit publik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

[redacted], Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik dhe
[redacted] Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, për mos ushtrimin e plotë të funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës e për rrjedhojë mos respektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007, pasi nuk kanë ushtruar kontrolle dhe konkretisht:

Për 25 raste, të konstatimit të vazhdimit të ndërtimeve pa leje, për të cilat janë mbajtur procesverbale, por nuk janë vendosur gjoba, siç përcaktohet në nenin 81"Sanksionet" të ligjit nr. 8405 datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", si dhe nuk janë marrë vendime për prishje objekti apo edhe kallëzim për ndjekje penale për subjektet ndërtuese, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 8 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007.

Nuk kanë ushtruar kontrolle lidhur me vendosjen e mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve, neni 7.

Nuk kanë ushtruar kontrolle lidhur me fillimin e punimeve nga subjektet ndërtuese, si dhe nuk ka kërkuar dhe detyruar zbatuesit e punimeve të plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me ndryshime.

Nuk kanë ndëshkuar me gjobë subjektet ndërtuese që nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve, sipas nenit 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998.

Nuk kanë ushtruar kontrolle në objektet private për zbatimin e kushteve teknike në ndërtim.

Nuk kanë ushtruar kontrolle në drejtim të marrjes së masave të sigurimit teknik dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve dhe krijimit të kushteve sipas Kodit Punës.

[redacted] Specialist i Mbrojtjes së Pyjeve dhe Tokave, pasi:

Nuk ka kryer as edhe një procedurë për marrjen në dorëzim të pasurive të paluajtshme të kaluara në pronësi të komunës, për rrjedhojë nuk është kryer as pasqyrimi në inventar dhe kontabilitet.

Nuk ka kryer rakordim me ZVRPP Durrës, për asetet në pronësi të komunës dhe nuk ka marrë në dorëzim hartat treguese të objekteve të paluajtshme pronë e komunës.

Nuk ka dokumentuar të dhëna të plota për trojet private dhe ato shtetërore, pasi mungon listimi i sipërfaqeve të trojeve private me analizë dhe atyre shtetërore.

Nuk ka filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve të kaluara me VKM.

Nuk ka kërkuar nga komuna të aplikohet në ZVRPP Durrës, për të kryer regjistrimin sipas listës, mbasi nuk ka kryer verifikimin, azhurnimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve, kusht i domosdoshëm për regjistrim.

[redacted] Punonjës i Policisë Komunare, pasi:

Nuk ka punuar me plane pune të planifikuara.

Nuk ka aplikuar gjoba ndaj subjekteve që nuk kanë paguar detyrimet, ambulantëve të ndryshëm që shesin në rrugë, ndërtimet pa leje, zënie të hapësirave publike, dhe ndotje e mjedisit.

Nuk ka bashkëpunuar me Zyrën e Tatim/Taksave, për arkëtimin e detyrimeve subjekteve debitore dhe nuk ka ushtruar kontrolle mbi territorin nën administrim, duke mos pasur evidenca për ushtrimin e aktivitetit nga subjekte të pa licencuara.

Për subjektet të cilët mund të operojnë në treg të paregjistruara nuk ka vepruar ashtu siç përcakton neni 49 pika 2/a të ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
Nuk ka bashkëpunuar me INU të Komunës, në drejtim të ushtrimit të kontrolleve mbi territorin nën administrim të Komunës, me qëllim parandalimin, e ndërtimeve pa leje.
Nuk ka bashkëpunuar me DSHP Durrës, në drejtim të ushtrimit të kontrolleve mbi territorin nën administrim të Komunës, me qëllim parandalimin, dëmtimin dhe shfrytëzimin pa leje apo kriter të pyjeve, në pronësi të komunës.
Për punonjësit të cilët aktualisht rezultojnë se u është ndërprerë marrëdhënia e punës me institucionin dhe nuk figurojnë si nëpunës civil konkretisht:
[redacted], nuk mund të rekomandojmë masa disiplinore, pasi masa konsiderohet e ezauruar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit, Fatmir Zilja, Ryisim Xhaja,Josif Lile, Margarit Stefa dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT